



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARE SHKODER

K Ë R K E S Ë
PËR PUSHIMIN E ÇËSHTJES

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR
S H K O D E R

Në përfundim të hetimit të procedimit penal nr. 194, të filluar në datën 12/02/2017, të regjistruar për veprës penale të parashikuar nga neni 287/1 të Kodit penal.

PARASHTRIMI I FAKTIT:

Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se pare Shkoder mbi bazen e materialit kallzues te percjelle nga Drejtoria Vendore e Policise Shkoder ka regjistruar procedimin penal Nr 194, date 12 Shkurt 2017, per vepren penale të parashikuar nga neni 287/1 te K.Penal ne ngarkim te shtetasit Kacjolin Zefi.

Nga verifikimet ka rezultuar se ne llogarine e shtetasit Kacjolin Zefi prane Intesa San Paolo Bank jane transferuar shume te medha parash nga shteti Italian , shume te cilat i ka terhequr cash . Konkretisht ne llogarine me nr 39095438001 (ne euro) nga viti 2014 deri ne vitin 2016 jane derdhur 275 mije euro prej te cilave 212 900 euro jane terhequr nga shtetasi Kacjolin Zefi. Ky shtetas ka gjithashtu edhe ne llogarine me nr 39095435102 (ne euro) hapur ne vitin 2008 tek ecila ka transferuar nga llogaria e tij ne banken Intesa San Paolo Bank shumen prej 104 900 euro si dhe ka bere derdhje dorazi shumen prej 57 475 euro. Nga kjo llogari rezulton te jete transferuar nje shume prej 32 500 euro ne llogarine e shoqerise “R. Cestaro” srl me pershkrimin “per blerje automjeti” shume te cilen e ka derdhur dorazi ne te njejten dite (date 26 maj 2016)

Transfertat jane bere nga shteti Italian kryesisht nga shoqeria Felix M”SRL por edhe nga shoqeri te tjera perfshi dhe nga vete shtetasi Kacjolin Zefi dhe kane pershkrime te ndryshme si psh ndertim kapanoni, tranferim fondesh , kursime biznesi, etj ndersa terheqjet e bera nga shtetasi



Kacjolin Zefi kane pershkrime te ndryshme si psh terheqje per nevoja familjare, terheqje per kredine , per pagesa ndertimi, transferim tek llogaria tjeter etj.

Shtetasi Kacjolin Zefi ka rregjistruar ne vitin 2007 shoqerine "Gersa -Z" shpk me objekt "tregtim me shumice dhe pakice , import -eksport te produkteve ushqimore " shoqeri e cila ka kaluar me status pasiv ne vitin 2010.

Ne perfundim te hetimit pasuror te kryer ne kuader te ketij procedimi penal ka rezultuar nder te tjera se shtetasi Kacjolin Zefi :

- Ne daten 20 janar 2012 ka rregjistruar mjetin me targa AA 968 CN , i markes mercedes-benz i cili eshte c rresgjitur ne menyre te perhershme ne daten 19 maj 2016
- Ne daten 25 maj 2013 ka rregjistruar mjetin me targa AA 480 GD (targa e meparshme AA 666 FO) i markes BMV te cilin e ka blere nga shtetasi Altin Keka me ane te kontrates se shitjes nr 1039/597 date 22 Maj 2013 kundrejt shumes prej 1 000 000 lekesh dhe me pas me ane te kontrates nr 4687/3033 date 15 prill 2015 ia ka shitur shtetasit Klaudio Tuku kundrejt shumes prej 500 000 lekesh (targa e re AA 078 NG)
- Ne daten 29 prill 2015 ka rregjistruar mjetin me targa AA 201 LO i markes Prosche Panamera te cilin e ka blere nga shtetasi Klaudio Tuku me ane te kontrates nr 4686/3032 date 15 prill 2015 kundrejt shumes prej 10 000 euro (targa e meparshme AA3331I) nderkohe qe ky i fundit e ka blere shtetasi Fjorentino Baxha me ane te kontrates nr 71/46 date 4 janar 2014 kundrejt shumes prej 1 000 000 leke ndersa vete shtetasi Fjorentino Baxha e ka blere nje vit me perpara ne vitin 2013 ne shumen prej 41 600 euro.
- Ne daten 25 gusht 2014 ka rregjistruar mjetin me targa AA 64 JP i markes Fiat Ducato te cilin e ka blere shtetasi Anton Koleka ne shtetin italian kundrejt shumes prej 500 euro dhe nje vit me vone ia ka shitur shtetasit Astrit Sakti me ane te kontrates nr 232/166 date 24 janar 2015 kundrejt shumes prej 250 000 leke
- Ne daten 3 qershor 2014 ka rregjistruar mjetin me targa AA 636 IY i markes Land Rover- Free Lander te cilin e ka blere nga shtetasi italian Mateo Sanpaolesi Cesaroni kundrejt prej 900 euro
- Ne daten 30 korrik 2015 ka rregjistruar mjetin me targa AA 973 LZ i markes Peugeot 407 te cilin e ka blere nga shtetasi Gjovalin Moleci me ane te kontrates se shitjes nr 4104/2844 date 27 Korrik 2015 kundrejt shumes prej 200 000 lekesh nderkohe qe ky i fundit e ka blere ne te njejten vit 9500 euro.
- Ne daten 12 korrik 2017 ka rregjisituruar mjetin me targa AA 303 OA i markes Ferrari California te cilin e ka blere ne Itali kundrejt shumes prej 32 5000 euro . Aktualisht ne



pronesi te shtetasit Kacjolin Zefi rezultojne automjetet me targa AA 201 LO, AA 636 IY, AA 973 LZ dhe AA 303 OA.

Sipas informacionit te vene ne dispozicion nga ZVRPP Shkoder shtetasi Pjeter Zefi , babi i Kacjolin Zefi ka blere pasurine nr 11/307 ,vol 21, fq 99 ZK 8593 truall 53 m2+ ndertese 10 m2, nr 11/107 +2-1, vol 21, ZK 8593 , ndertese 100 m2 dhe Nr 10/64 +1-3, vol 4, fq 20 ZK 8593 apartament 78 m2 . Ndersa sipas informacionit te vene ne dispozicion nga ALUIZNI ky shtetas eshte pajisur me leje legalizimi per nje objekt prej 95 m2 ndertuar mbi nje siperfaqe parcele 279 m2 .

Shtetasi Kacjolin Zefi rezulton te kete punuar nga muaji Gusht 2008 prane shoqerise "Felix M" shpk si shofer kamioni dhe per rrjedhoje ka hapur llogari page me nr 39095435101 ne te cilen pervec kreditimit te pages e cila ka qene fillimisht 15000 leke me pas ne 20000 leke dhe se fundi 30000 leke jane depozituar dhe shuma te vogla parash prej atij vete, shtetases Vjollca Mesi apo jane transferuar shuma te tilla ne emer te motres se tij Madalena Zefi.

Shoqeria "Felix M" eshte rregjistruar ne vitin 1998 (ne vitin 2007 ka blere shoqerine Generale Made) dhe ka si objekt te veprimtarise se saj prodhimin e konfeksioneve dhe ka tre ortakë, perkatesisht Luisa Tilli 80 % e kuotave, Madalena Zegi 10 % te kuotave, dhe Kety Michelessi 10 % te kuotave. Shtetesja Luisa Tilli ka deklaruar se parate jane transferuar prej saj e llogari te shtetasit Kacjolin Zefi per llogari te shoqerise "Felix M" shpk me qellim blerjen e kapanonit apo kryerjen e pagesave te ndryshme.

Nga ana e Prokuorise Shkoder eshte bere dergimi ne gjyq i procedimit penal Nr 194 ne ngarkim te te pandehurit Kacjolin Zefi per vepren penale te parashikuar nga neni 287/a te K.penal .Gjykata e Shkalles se pare Shkoder ne seancen paraprake ka vendosur kthimin e procedimit penal Nr 194/2017 per hetime te metejshme.

Nga ana e te pandehurit Kacjolin Zefi, ne vijim te plotesimit te hetimeve te ketij procedimi ka dorezuar akte shkresore te marra ne formen e kerkuar nga ligji me vule apostile te te ardhurave financiare ne Itali te personit Kacjolin Zefi.

Nga keto dokumente rezulton se shtetasi Kacjolin Zefi ka banuar ne shtetin Italian nga viti 1991 deri ne vitin 2013 si dhe gjate kesaj periudhe ka punuar pjeserisht ne pune te deklaruar tek autoritet italiane duke siguruar nje kontribut zyrtar ne te ardhura ne shumen 46.645 euro. Shuma e deklaruar pa perfshire pjesen e punes qe ka bere ne pune te padeklaruar zeror, detyrimin e llogaritur ne te ardhurat e e tij

Per kete arsye ka paraqitur Komunikim certifikues i llogarise siguruese me numer praktike 2058838800128 ne emer te Kacjolin Zefi , Sigurime shoqerore Ekstrakt i llogarise Sigurimeve



Shoqerore , rexhim i pergjithshme i leshuar ne daten 19.12.2019 ne emer te Kacjolin Zefi, me kod fiscal ZFECKJ65T18Z100D, banues ne Via papa Giovanni XXIII 28, 63078, Montepredone AP. Deklarate noteriale nr 3668 rep nr 1864/1 kol date 18.07.2019 te leshuar nga shtetesja italiane Katy Michelessi perpara noter Juled Beqiraj me ane te ciles ka deklaruar se: “Jeton ne nje shtepi te sajen ne Montepredone, shtepi ne te cilen ka mirepritur Z Kacjolin Zefi i cili ka jetuar ne shtepine e saj pa pagese qeraje per periudhen 02.10.1999 deri ne 24.06.2013 duke paguar jetesen e tij ne cdo drejtim si per ushqim , veshmbathje, drita uje dhe taksa. Ky deklarim shoqerohet me akte shkresore ne te cilat deklaruesja provon pronesine mbi banesen, gjendjen financiare te saj per mbulimin e shpenzimeve.

Procesverbal depozitimi te diferences se cmimit per shumen 132. 880 000 lireta. Akt te shoqerise permbartimore per leshimin ne favorin e Katy Michelessi te certifikates Deklaraten zevendesues te aktit noterial te dates 19.10.2001 per posedimin e pasurise. Procesverbalin e shitjes ne ankand. Pyetjen e shtetases Katy Michellese per faktet e deklaruar ne deklaraten noteriale . Deklaraten noteriale te te ardhurave te Katy Michellese per vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015.

Mbi bazen e vendimit nr 523(1417) date 07.05.2020 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder ka vendosur mospranimin e kerkeses se Prokurorise se Rrethit Shkoder ka vendosur pushimin e hetimit te ketij procedimi dhe ka kerkuar te kryehet akt ekspertimi kontabel dhe vleresues per te vertetuar elementet e vepres penale te “ Pastrimit te produktit te vepres penale”.

Nga akti i ekspertimit kontabel ku nder te tjera ka rezultuar se pasuria e shtetasit Kacjolin Zefi mbulohet nga te ardhurat e tij te ligjshme . Gjithashtu eshte kryer dhe akti i ekspertimit Vleresimit te mjeteve ne pronesi te Kacjolin Zefit per mjetet ne pronesi te tij.

Nga hetimet e kryera dhe provat e administruara rezulton se ne rastin konkret nuk konstatojme elementet e vepres penale te “Pastrim te produktit te vepres penale ”, parashikuar nga neni 287/1 i K.penal, nuk provohet ekzistenca e nje vepre penale kriminale qe xheneron te ardhura te paligjshme.

Për këto arsye, në mbështetje të nenit 328, pika 1, geramat “b” te K.Pr.Penale,

K Ë R K O J:

Pushimin e hetimeve te procedimit penal nr.194, viti 2017, për veprën penale “Pastrim te produktit te vepres penale te”, parashikuar nga neni 287/1 i K.penal

Av. Beqir Lita

PROKURORI
XHEVAHIR LITA

